

# MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet

**INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE**

dhe

**MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME**

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Ministria e Punëve të Jashtme, këtej e më poshtë referuar si "palët",

Me qëllim:

- realizimin e bashkëpunimit të ndërsjellët ndërmjet dy palëve në luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar;
- përshpejtimin e procedurave ligjore për verifikimin dhe hetimin e rasteve të pasurive të paligjshme jashtë vendit;
- bashkërendimin e veprimeve nëpërmjet përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë dhe institucioneve të huaja që realizojnë procesin e luftës kundër korrupsionit;

Ranë dakord si vijon:

Për qëllimet e këtij Memoradumi termi "MPJ" nënkupton Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe termi "ILDKP" nënkupton Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

Të dy palët, në bazë të shkronjës "ç" të nenit 17 të Ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", do të angazhohen për një bashkëpunim konkret me qëllim krijën e luftës kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik.

ILDKP, në rastet e marrjes së informacioneve si dhe nga të dhënat e paraqitura në dokumentin "deklaratë pasurie" për pasuri jashtë vendit të subjekteve të ndryshëm, në zbatim të pikës 5 të nenit 14 të Ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", do t'i drejtohet MPJ-së me kërkesë për të bashkëpunuar në mbledhjen e provave (dokumenteve shkresore) lidhur me verifikimin e të dhënave të deklaratës së pasurisë.

Ky bashkëpunim do të realizohet nëpërmjet përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë, të akredituar pranë vendit ku deklarohet ekzistenca e pasurisë së subjekteve të ndryshme

Në këto raste, ILDKP-ja do të verë në dispozicion të përfaqësive diplomatike përkatëse një autorizim që lejon mbledhjen e të dhënave dhe dokumenteve të ndryshme të pasurisë të subjektit, kudo ku ato ndodhen në shtetin ku është akredituar përfaqësia diplomatike.



MPJ nëpërmjet rrugëve diplomatike do të angazhohet për mbledhjen e informacioneve të kërkuara, pranë të gjitha organeve publike dhe private, të shteteve ku përfaqësitë diplomatike shqiptare janë akredituar, në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë dhe të vendeve përkatëse, si dhe me ndërkombëtare shumëpalëshe.

MPJ, në bazë të kërkesës së ILDKP-së, gjithashtu do të angazhohet për krijimin e kontakteve me institucionet homologe të ILDKP-së në shtete të tjera dhe për përfundimin e marrëveshjeve dypalëshe të bashkëpunimit, me qëllim koordinimin dhe mbledhjen e të dhënave personale që lidhen me pasuritë e paligjshme të zyrtarëve publikë dhe atyre të zgjedhur.

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit.

Ky Memorandum Bashkëpunimi hartohet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, njëra prej të cilave depozitohet në MPJ dhe kopja tjetër depozitohet në ILDKP.

Ky Memorandum Bashkëpunimi u nënshkrua në Tiranë, më datë 9 nëntor 2005.

**Për Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive**

**Për Ministrinë e Punëve të Jashtme**

**INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM**

**MINISTRI**

**FATMIRAJ LASKA**

**BESNIK MUSTAJ**



**Memoranda of understanding  
Between  
High Inspectorate of Declaration and Audit of Assets  
And  
Ministry of Foreign Affairs**

The High Inspectorate of Declaration and Audit of Assets and the Ministry of the Foreign Affairs, now and on referred as the “ parties”,

**With its main objective:**

- The accomplishment of the common collaboration between the two parties in the fight against corruption and organized crime.
- The acceleration of the legal procedures concerning the investigation and the verification process of illegal assets abroad.
- The coordination of the actions taken by the Diplomatic Representatives of the Albanian Republic and the foreign institutions that accomplish the process of the fight against corruption;

**We agreed on as it follows:**

For the purpose of this memoranda the term “MPJ” applies to the Ministry of Foreign Affairs and the term “ILDKP” applies to the High Inspectorate of Declaration and Audit of Assets.

Both parties in compliance with the letter “c” of the article 17, law no.9049, date 10 April 2003 “On the declaration and audit of assets, financial obligations of elected persons and certain public officials”, will be committed in a collaboration with the main objective the fight against corruption and the economic crime.

ILDKP/HIDAA, as soon gets the information as a result of the disclosed document “declaration form”, concerning the assets of any different subject abroad, in compliance with point 5, article 14, law no. 9367, date 7 April 2005 “On the prevention of conflicts of interest in the exercise of public functions” will be addressed, in a form of an official request, to MPJ to collaborate for the collection of the data (by means of official documentation) concerning the verification of the data disclosed in the declaration form.

This collaboration will be accomplished by means of the Diplomatic Representatives of the Albanian Republic, accredited in the countries where the possession of the assets of different subjects is declared. In such cases, ILDKP/HIDAA will make available to the Diplomatic Representatives an authorization by means of which it allows the collection of different data and various documents of the assets of the

mentioned subjects, wherever they are in the country where the Diplomatic Representatives are accredited .

MPJ, by means of its Diplomatic Representatives will be committed to collect the required information, in the private and public sector, of the countries where the Albanian diplomatic representatives are accredited , in full compliance with the legislation of the Albanian Republic and of the other countries, as well as with the international multilateral dispositions.

MPJ, being upon the request of ILDKP/HIDAA, will be committed to set contacts with the counterpart institutions of ILDKP/HIDAA in other countries as well as to conclude the bilateral agreements of collaboration, so that the coordination and the personal data collection related to the illegal assets of the public servants and of the elected ones will be met.

This Memoranda of Understanding enters into force since it was signed.

This Memoranda of Understanding is compiled in 2 original copies in the Albanian language, one of which is stored at MPJ and the other is stored at ILDKP/HIDAA.

This Memoranda of Understanding was signed in Tirana, date 9 November 2005

**For the High Inspectorate of  
Declaration and Audit of Assets**

**THE GENERAL INSPECTOR  
FATMIRA LASKA**

**For the Ministry of  
Foreign Affairs**

**THE MINISTER  
BESNIK MUSTAJ**